

Reagim në artikullin “Privatizimi i KEDS-it pamundëson liberalizimin e vërtetë të energjisë”

KEDS e pa të domosdoshme të përgjigjet në artikullin e BIRN-it me titull: “Privatizimi i KEDS-it pamundëson liberalizimin e vërtetë të energjisë”, publikuar në portalin kallxo.com me 6 shkurt 2020. Artikulli përmban pakorrektesi dhe pohime të pasakta, për të cilat BIRN nuk ka bërë përpjekjen më të vogël për të argumentuar ose kontrolluar legjitimitetin e tyre. Titulli keqinformues dhe konstatimet e pabazuara ndikojnë negativisht në reputacionin e kompanisë sonë dhe mashtrojnë publikun. Prandaj, ne duam të sqarojmë çështjet që u pohuan gabimisht në artikull.

Duhet të sqarohet se, si shumë shembuj të tjerë në të gjithë botën, biznesi i shpërndarjes së energjisë elektrike është një monopol natyror. Nëse do të konsiderojmë vetëm periudhën e fundit 6-vjeçare (2013-2019) KEDS ka investuar më shumë se 147 milion Euro në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike të Kosovës. Prandaj, kostoja e ndërtimit të një infrastrukture të tillë është shumë e kushtueshme dhe e vështirë; është e padiskutueshme dhe pothuajse e pamundur për çdo palë tjetër të kryejë të njëjtat aktivitete. Nga ana tjetër, ligjet dhe rregulloret e tanishme lejojnë të gjithë furnizuesit e licencuar, në mënyrë të drejtë dhe pa asnjë kusht specifik të furnizuesit, të furnizojnë energji elektrike për çdo klient në Kosovë, përmes rrjetit të KEDS. Fatkeqësisht, BIRN nuk mund të bëjë dallimet thelbësore midis shpërndarjes së energjisë elektrike dhe furnizimit me energji elektrike, cka bëri të shkruajë një artikull plotësisht keqinformues dhe të pasaktë.

“Aktualisht në Kosovë nuk ka energji elektrike në dispozicion që të mund të tregtohet nga furnizuesit e energjisë, e nuk ka as klientë që mund të furnizohen qoftë edhe nga tregu i jashtëm”, thuhet në artikull. Fatkeqësisht, ky pretendim është plotësisht i pakuptimtë. E vërteta është se të gjithë furnizuesit e licencuar të energjisë elektrike në Kosovë që kanë përmbushur detyrimet e tyre ligjore kanë shumë mundësi për të blerë energji elektrike: ata mund të importojnë energji aq sa dëshirojnë ose të marrin pjesë në tenderët e prodhuesëve lokalë për shitje të energjisë elektrike ose të blejnë direkt nga prodhuesit tjetër lokalë apo edhe të blejnë nga furnizuesit e tjerë. Pas këtij hapi, këta të licencuar mund të furnizojnë me energji elektrike të gjithë konsumatorët, në varësi të dëshirave dhe interesit të tyre, përmes rrjetit KEDS me të njëjtat kushte si furnizuesit e tjerë.

BIRN konstaton tutje se “Liberalizimi i tregut të energjisë është pamundësuar edhe me rastin e privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit”. Kjo nuk është e vërtetë. Privatizimi i Distribucionit vetëm sa ia ka lehtësuar rrugën liberalizimit të tregut dhe ka mbështetur zhvillimin e rrjetit.

BIRN gjithashtu pretendon se konkurrenca pengohet nga fakti se KEDS dhe KESCO kanë të njëjtin pronar dhe janë privatizuar nga i njëjti pronar. Kjo nuk është e vërtetë. gjithashtu ka nevojë për një korigjim thelbësor: KESCO nuk është privatizuar si kompani, ajo është ndarë nga KEDS për hir të konkurrencës, gjatë fazës së fundit të shthurjes. Pra, është një kompani e krijuar pothuajse dy vjet pas privatizimit të KEDS, pikërisht për të hapur rrugën për liberalizimin e tregut.

Edhe po të ishte ashtu, kjo nuk mund të konsiderohet as si pengesë. Në tregjet më të mëdha të liberalizuara dhe të zhvilluara të Evropës, të tilla si Gjermania dhe Britania e Madhe ka kompani që kanë një përqindje të madhe të shitjeve të energjisë në vend dhe kryejnë veprimtari të tjera të rëndësishme si prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe furnizimi i energjisë elektrike. Ky "integrim vertikal" i bizneseve nuk pengon ose prish konkurrencën. Përkundrazi, i ndihmon konsumatorët me çmime më të ulëta për shkak të rritjes së efikasitetit të përgjithshëm.

BIRN tutje merr një nga pronarët e kompanivë të licencuara për furnizim me energji elektrike, i cili ia huq dhe mediumi në fjalë nuk merr mundin të verifikojë faktet. “Vendimi që mos të dalin në treg konsumatorët e kyçur në nivelit 10kV dhe atyre 04kV, do të thotë që ne s’kemi kënd me furnizu. Në Kosovë nuk ka energji elektrike në dispozicion që të mund të tregtohet, po ashtu nuk ka as klientë që mund të furnizohen qoftë edhe nga tregu i jashtëm”, citohet ai.

Ky është një tjetër pohim që nuk qëndron. E vërteta është se klientët e lidhur me nivelet 10 kV dhe 0.4 kV kanë tarifën e tyre të rregulluar nga ZRRE por ata janë gjithashtu të lirë të zgjedhin furnizuesit e tyre. Me fjalë të tjera, ata konsumatorë kanë të drejtë, por ata nuk janë të rregulluar (d.m.th. mbetur pa mundësinë e blerjes së energjisë me tarifa të rregulluara) si pjesë e fundit e liberalizimit. Kjo për shkak se, rregullimi i konsumatorëve do të rrisë çmimet e furnizimit të tyre, për shkak të kushteve aktuale të tregut. Për të shmangur çdo rritje në kostot e tyre të energjisë, bizneset dhe shoqatat që mbrojnë bizneset reagojnë dhe kanë arritur të shtyjnë këtë proces përmes Kuvendit të Kosovës. Pjesa e dytë e këtij konstatimi të paskatë është shpjeguar në fillim të reagimit. Me fjalë të tjera, liberalizimi i tregut nuk mund të sjellë përfitime për konsumatorët fundorë, pasi çmimet bazuara të tregut për njësi (d.m.th. kosto për njësi të energjisë) është më e lartë se kostoja e energjisë së prodhuar në vend që është në dispozicion për konsumatorët fundorë përmes tarifave të rregulluara.

Ndërkohë, BIRN lejon drejtorin e furnizuesit tjetër të licensuar, të jepë hamendësime, të cilat janë akuza të rënda për KEDS, pa ofruar asnjë fakt të vetëm. “Ne e dimë që këtu ligji nuk funksionon, askush nuk na garanton neve që KEDS-i nuk ua ndalë rrymën e nuk tallet më ta qëllimisht duke u arsyetuar se ka probleme në rrjet e të tilla. Problemi kryesor është që kompania, konkurrenti kryesor i yni KESCO, është pronar te kompania që e ka distribucionin që është problem goxha i madh për me zhvillu konkurrencë”.

KEDS është një kompani serioze, e cila ka afro 2000 punëtorë profesionistë që bëjnë përpjekje maksimale duke punuar fort çdo ditë që të ofrojnë shërbimet më të mira të munshme, në mënyrën me efikase.

KEDS mban dhe e di përgjegjësinë për t’u shërbyer 24/7 të gjithë qytetarëve të Kosovës, edhe në kushtet më të vështira atmosferike. KEDS është duke bërë çmos për të rinovuar dhe zhvilluar një rrjet të trashëguar në gjendje të rëndë, ku nuk janë bërë investime të mirëfillta dekada me radhë. KEDS zbaton ligjet dhe është e angazhuar për trajtimin e barabartë të secilit konsumator, pavarësisht se nga vije.

Dhe në fund të fundit, KEDS është një kompani, aktivitetet e së cilës janë rregulluar dhe monitoruar rreptësisht nga ZRRE dhe të gjitha institucionet e tjera zyrtare të Kosovës.

Përgjigje në reagim

Faleminderit për e-mailin tuaj.

Reagimi i juaj është publikuar në rubrikën: Letër Redaksisë, ndërsa pjesë të saj janë inkorporuar edhe në fund të tekstit.

Sa i përket pikave të ngritura në reagimin tuaj, na lejoni të sqarojmë si në vijim.

Autorja e ka bërë dallimin në mes të KEDS-it dhe KESCO-së, mirëpo titulli i referohet kohën kur është privatizuar Rrjeti i Shpërndarjes dhe Furnizimi dhe në atë kohë të dy ndërmarrjet janë njohur si KEDS. Edhe privatizimi i KEDS-it nuk është proces që është bërë nga KEDS-i, mirëpo privatizimi është bërë nga Qeveria e Kosovës me miratim të Kuvendit të Kosovës.

Ndërlidhja e liberalizimit të tregut me KEDS-in nuk është bërë për shkak të **monopolit natyral të Rrjetit të Shpërndarjes**, por për shkak të obligimeve që dalin nga shitja e energjisë me shumicë nga KEK-u.

Në artikull vazhdimisht është referuar si liberalizmi real, meqë është e qartë se në letra tregu është i liberalizuar.

Edhe çështjet që lidhen me prolongimin e liberalizimit të plotë të tregut nuk është fajësuar KEDS-i, por janë adresuar saktë arsyet e prolongimit dhe kanë folur edhe përfaqësuesit e bizneseve. Autorja e ka përfshirë në tekst edhe përgjigjen e KEDS-it sa i përket liberalizimit të tregut.